

VENDIM
Nr. 302, datë 21.5.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 649, DATË 8.10.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË DREJTËSISË TË NJË PJESE TË PRONËS NR. 17/16, ME EMËRTIM
“ISH-DREJTORIA E DOGANËS, DURRËS”, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 586, DATË 10.9.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR MIRATIMIN E LISTAVE TË INVENTARËVE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT U KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI SHOQËRIVE ANONIME DHE NDËRMARRJEVE TË SISTEMIT
TË TRANSPORTIT DETAR DHE AJROR””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 649, datë 8.10.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
a) Në fund të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave, shtohen fjalët: “... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës, dhe Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, Durrës, sipas planimetrisë bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.”.


b) Sipërfaqja e ndërtesës prej 172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy) m², me emërtim “Ish-Drejtorja e Doganës, Durrës”, pjesë e pronës nr. 17/16, në zonën kadastrale nr. 8514, me vendndodhje në sheshin “Mujo Ulqinaku”, për përdorim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Durrës, dhe sipërfaqja e ndërtesës prej 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) m², për përdorim nga Zyra Vendore e Shërbimit të Provës, Durrës, shtohen në listën e inventarit të pronave shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



AMBIENTET SIPAS FUNKSIONEVE



35




PLANIMETRIE RI KONTAKTUAL KATI II




SHEJMI : D1 = 1.70 M
D2 = 1.95 M

mi "Codine 2 Kuj" Durres
 Zyrat e Permbanimit



MIRATOHEJT
 R.R.T. e BASHKISE DURRES
 KRYETARI
 ofter KOKA

TAM K.R.R.T. e BASHKISE DURRES
 der CEMKUPA



Seshi "Mujo ULQINAKU"
 Zyrat e Permbanimit

Seshi ndertimit
 Zyrat e Permbanimit
 Kati II-Rikonstruksion

PORTI DETAR DURRES

